

## **A N E K S I 1**

Termat e Huasë paraqiten si vijon:

**Shuma e Huasë 295,420,000** (dyqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e katërqind e njëzet mijë) SDR

**Norma e Interesit** është e lidhur me normën e interesit për SDR, *që aktualisht është 1.13 %*. Ky interes do të paguhet për shumën e kredisë së tërhequr dhe të pa shlyer deri në masën 180,000,000 SDR (që përbën 300% të kuotës së anëtarësisë).

Për pjesën e huasë të tërhequr dhe të pashlyer mbi shumën e mësipërme, aplikohet një interes i barabartë me normën bazë + 200 bp. Në rastet kur shuma e kredisë së tërhequr dhe të pashlyer kalon vlerën 180,000,000 SDR për një periudhë mbi tre vjet, norma shtesë që aplikohet mbi normën bazë të referencës rritet në 300 bp.

**Komisioni i Angazhimit**, aplikohet në çdo fillim periudhe 12-mujore nga data e aprovimit të huasë në Bordin e FMN-së, mbi shumën që parashikohet të tërhiqet gjatë kësaj periudhe. Norma e këtij komisioni është 15 bp (0.15%) për shumën të angazhuara që nuk e kalojnë vlerën prej 120,000,000 SDR (që përbën 200 % të kuotave të anëtarësisë së Shqipërisë në FMN), ndërsa për shumën të angazhuara që e kalojnë këtë vlerë norma e komisionit rritet në 30 bp (0.3%).

Ky komision i rimburohet vendit në rast se tërhiqet e gjithë shumën e huasë së angazhuar brenda afatit të parashikuar.

**Komisioni i Shërbimit**, aplikohet mbi çdo shumë që tërhiqet nga huaja dhe është në masën 50 bp (0.5%).

**Maturimi i Huasë** është 13 vjet dhe përfshin një grace-periode prej 4 vjetësh.